



Asambleja
01.Nr.VIII
Deçan,dt.30.05.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të të rregullt të Asamblesë Komunale, me dt.30.05.2022.

Në mbledhje ishin prezent: 26 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut në Deçan,
4. Raporti vlerësues i Programit tre vjeçarë për Banim social në komunë 2018-2020 dhe marrja e vendimit për hartimin e Programit Komunal për banim social 2022-2025,
5. Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë,
6. Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për barazi gjinore,
7. Themelimi i komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave,
8. Raporti vlerësues për ish PLVM 2012-2017 dhe marrja e Vendimit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2022-2026,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e mbledhjen VIII-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e V-të e rregullt e Kuvendit, duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 26 antarë të Kuvendit (mungon Shkelqim Tolaj).

Kryesuesi- e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, i njëjti miratohet njëzëri.

Kryesuesi- e prezantoi kërkesën për caktimin e lokacionit me destinim për varrezat e Lagjes Nuraj të fshatit Strellc i Ulët, kërkesë e cila është shqyrtuar në mbledhjen e KPF-së të muajit prill.

Njëzëri asamblistët vendosin që kjo kërkesë të hyn në rend dite dhe të shqyrtohet si pikë e veçantë.

Orges Tafilaj- ka kërkuar, në të ndryshme, qoftë si pikë informuese, të ipet njoftim rreth Takimit të komisionit të kuvendit dhe bisedimeve me menaxhmentin e KRU"Hydrodrini" për situatën e furnizimit me ujë të pijes dhe kualitetin e ujit.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Orges Tafilaj- në fq.2 te pika dytë e rendit të ditës para tekstit "a ka planifikim të rrjedhës së parasë " të shtohet teksti "meqenëse janë bërë shumë pagesa që tejkalon planifikimin buxhetor".

Erdogan Dautaj- kërkon që të bëhet ndryshim te fjala e tij, ku duhet të jetë në rrugën "Qendra" e jo rruga Carrabreg të lejohen dy kyqe të reja dhe përgjigja e kryetarit të Komunës se do ti lejojnë këto dy kyqe.

Miratohet njëzëri procesverbali me plotësime.

II. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore.

Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia ka dhene drejtoreshës se drejtorisë per buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, e cila per te pranishmit ka sqaruar se, buxheti i komunës se Deçanit per vitin 2023 sipas Qarkores se pare buxhetore 2023/01 është 12,113,806.00 €, ka rritje të hyrave komunale, edhe kete vit shqetësim i yni mbetet minusi te granti i arsimit. Qarkorja vjen ne kete forme nga Ministria dhe ne tash në bazë të sajë i organizojmë 4 debate publike, që janë : një për

grantin e Shëndetësisë, një për grantin e Arsimit, një debat i organizuar nga KPF-ja me Këshillat e fshatrave dhe një debat i përgjithshëm me qytetar i organizuar nga Asambleja komunale.

Hyri Dobrunaj- thot se sipas Qarkores 2023/01, 166 norma tepër janë në arsim, kërkon që planifikimi buxhetor të përgaditet në mënyrën ma të mirë të mundshme, dëgjimet publike organizohen me qytetar dhe për qytetar dhe propozoj që KPF me dalë në teren nëpër fshatra dhe me pa për së afërmi nevojat e qytetarëve e pastaj të planifikohet buxheti sipas kërkesave dhe nevojave në teren.

Orges Tafilaj- thot se paraprakisht duhet të na dërgohet realizimi i buxhetit të vitit 2022, pastaj shtron pyetjen, a kini si ekzekutiv plane për projekte konkrete, apo i lini ato pas debateve publike që do të organizohen për Qarkoren e parë buxhetore.

Drejtoresha sqaron se ky dokument është në formën si ka ardhë nga ministria , planifikimet i bëjmë pas evidentimit të nevojave dhe kërkesave në teren.

Erdogan Dautaj- pyetje, sa për % do të realizohen të hyrat vetanake dhe a i kini planifiku projektet kapitale, për të cilën përgjigjet drejtoresha, se kapitalet ende nuk janë planifiku.

Faton Selmanaj-thot se pajtohem me Hyrinë që KPF të del në teren, në mënyrë që ti shofim prioritetet dhe kërkesat e qytetarëve.

Hyri Dobrunaj-thot, sa ju përket të hyrave, projeksionet veq jan ba.

Florim Mataj- thot se nuk pajtohet me idenë që KPF të del në teren, unë nuk e miratoj këtë propozim, sepse ne e kemi një kryetar dhe drejtorat e drejtorive të cilët i përcaktojnë prioritetet në vija të trasha pas ardhjes së Qarkores së parë buxhetore.

Erdogan Dautaj- thot se është ma mirë që kërkesat e komunitetit me ardhë përmes kryetarëve të fshatrave, se sa KPF me dalë në teren.

Leotrim Hadergjonaj-thot se me të drejtë e ka drejtoresha e cila planifikon te rriten te hyrat sepse kete vit i kemi edhe 4 objekte te reja qe pritet te gjenerohen te hyra nga ato, realizimi i buxhetit vitin e kaluar ka qenë 70% dhe besoj se kete vit kjo përqindje do te rritet.

Vatan Istrefaj- nuk pajtohem me Florimin qe tha e dini se ka një Kryetar dhe drejtorat.

, po pse mos me dale ne teren edhe na si KPF, çka ka te keqe këtu.

Yllarta Thaqi- edhe unë e përkrahi Florimin lidhur me propozimin e daljes ne teren te KPF-se , sepse salla e asamblesë eshte, Kryetari është, janë edhe drejtorat dhe nëse dalim ne teren duket se kemi nisë fushatë të re zgjedhore.

Kryesuesi- thot se zgjedhjet lokale te mbajtura vitin e kaluar nuk janë largë sepse çdo njëri prej nesh kemi dalë në teren në fushatë për zgjedhje dhe i kemi të freskëta kërkesat e qytetarëve.

Albesa Cacaj- thot se jemi dëshmitarë të dëgjimit publik për Statutin e muzeut ku salla mbushet me punëtorë të administratës komunale, dhe dalja ne teren sipas meje është ma e arsyeshme sepse kemi pasë raste kur kryetarët e fshatrave kanë thënë pi ngrisim edhe një herë këtë çështje te cilën e kemi ngritë disa here deri tash por nuk është realizu, buxheti është i qytetarëve jo i joni, nuk po kërkojmë diçka të jashtëzakonshme nëse kërkojmë që KPF te del ne teren.

Yllarta Thaqi- replikë me Albesen, gjithmonë njoftimet për debate me qytetarët janë bërë me kohë por qytetarët nuk kanë ardhë sepse nuk janë të interesuar vet të vijnë në debate, ndërsa per buxhet nëse ti ki projekt konkret propozo dhe pastaj debatohet per te.

Albesa Cacaj- pyet , pse është kjo pjesëmarrje kaq e ulët e qytetarëve në debate publike, a mos është humbje e besimit te ju si pushtet lokal, formalitet zhvillohen në këtë rast por sa realizohen premtimet e juaja.

Kryesuesi- thot se çdo kush në zgjedhje del me program te vet, edhe na si parti kemi dalë me program tonin, të cilin synojmë ta realizojmë, na me kete program i kemi fitu 65% të votave ne zgjedhje.

Mon Selmonaj-thot se eshte e vertete qe the kryesues qe me kete program i kini fitu 65% por nuk duhet te injorohet opozita, ne kemi obligim para qytetarëve, ne jemi këtu per te gjitha nevojat e qytetarëve, pastaj ai ka pasë vërejtje se diku, në disa lokalitete, projektet po shkojnë ma shum ndërsa diku nuk ka fare ndërhyrje me investim te projekteve kapitale.

Hyri Dobrunaj- thot debatin e degjenerove vet ti kryesues kur the i kemi fitu 65% te votave, dhe kërkoj që kjo do të jetë hera e fundit që shprehesh kështu, përndryshe ne si opozitë nuk do të marrim pjesë në mbledhje nëse përsëritet kjo thënie edhe një herë.

Florim Mataj- thot se nuk jamë kundër daljes në teren si KPF por të gjitha projektet që janë në të mirë të qytetarëve na i përkrahim këtu në kuvend.

Mon Selmonaj- nuk fola për KPF fare por vetëm për obligimin ndaj qytetarëve dhe orientimin e projekteve në disa rajone.

Drejtori Administrates, Jashar Dobraj-sqaron se Qarkorja e parë buxhetore i dedikohet të gjitha subjekteve politike pa dallim dhe është ma tepër si njoftim, ndërsa kur të vjen Qarkorja e dytë, ajo i cakton kufijtë buxhetor dhe KPF atëherë mund të cakton takime dhe të del në teren, KPF merr obligime pasi të vjen Qarkorja e dytë.

Hyri Dobrunaj- thot se ne kemi dhënë sugjerime për planifikim të buxhetit për kohën kur vjen Qarkorja e dytë, por saktë është ajo çka deklaroj drejtori, Jashari.

Kryesuesi- thot se nuk e thash në kontestin negativ atë rezultatit e zgjedhjeve.

Faton Selmanaj- thot se ne folëm për një plan orientues dhe nëse ju nuk dëshironi si ekzekutiv ne si KPF mund të dalim në teren.

Drejtori, Jashar Dobraj-thot se ekzekutivi ka obligim për ta sjellë para kuvendit planin për buxhet dhe nuk mundeni ju si opozitë me dalë në teren pa një plan paraprak të buxhetit të pergaditur nga ekzekutivi komunal.

Kryesuesi- ka paraqitë kërkesë për drejtoreshën e buxhetit, të bëhet planifikim i buxhetit për rregullimin e sallës së Kuvendit. Kryesuesi ne vazhdim ka thënë se duhet të mbahen 4 debate publike për Qarkoren e parë, ku duhet të formohen edhe grupet punuese për organizimin e debateve publike, duhet të formohet grupi punues për organizimin e debatit publik për Grantin e Arsimit, grupi për organizimin e debatit publik për grantin e Shëndetsiesë, KPF-ja organizon debatin publik me Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe Asambleja organizon debatin e përgjithshëm publik me qytetar, kryesuesi ka propozuar që grupet punuese të perbehen nga 5 anëtar ose të propozohet ndryshe nëse nuk pajtohen me kete propozim.

-Formohet grupi punues për organizimin e debatit publik për Qarkoren Buxhetore 2023/01-Granti për Shëndetësi, në përbërje: Lulavere Qorraj-Selmanaj (AAK), Shkodran Mustafaj (AAK), Lendita Berisha(AAK), Sylë Balaj(LDK), Teuta Neziraj(LVV). Përbërje e cila miratohet njëzëri.

-Formohet grupi punues për organizimin e debatit publik për Qarkoren Buxhetore 2023/01-Granti për Arsim, në përbërje: Floriana Hulaj(AAK), Arjan Dobraj(AAK), Elmedina Sadikaj(AAK), Sylejman Lokaj(LDK), Valiant Mataj(LVV). Përbërja e komisionit miratohet njëzëri.

KPF do të bënë organizimin e debatit publik me Kryetarët e Këshillave të fshatrave, ndërsa Asambleja do të organizon debatin e përgjithshëm publik me qytetarët e komunës së Deçanit.

III. Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut në Deçan.

Kryesuesi – e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj, e cila sqaron se sipas procedurës së paraparë ligjore pas kalimit në leximin e parë Statuti i është nështruar diskutimit publik, mirëpo në debat nuk ka qenë i interesuar askush me marrë pjesë përveç kolegëve të Komunës, duhet cekur se ne nuk e kemi marrë përgjigjen nga Ministria për Vendimin e kuvendit, si akt i kuvendit të komunës për themelimin e Muzeut, mirëpo pas konsultimeve lidhur me ligjshmërinë e vendimit për themelimin e muzeut të Deçanit, jemi sugjeruar që të vazhdojmë me procedura, pasi që afati ligjor i hyrjes në fuqi të vendimit është 15 ditë as dërgimit në Ministri, në vazhdim ajo njofton se janë bërë ndryshimet e propozuara nga kuvendi në leximin e parë, që janë :Akti i themelimit të Muzeut, Artefaktet janë pronë komunale ndërsa objekti pronë e ministrisë, Shërbimet bëhen me pagesë, së paku tri vite përvojë pune duhet të ketë kandidati që konkurren për drejtor të Muzeut, ndërsa sa i përket gjyrollogarisë ka pasë dy propozime, njëri që duhet të ketë gjyrollogari të veten Muzeu dhe propozimi tjetër që nuk lejohet kjo gjë, por si do qoftë ju sot vendosni për nenin që përcakton se duhet ose nuk duhet të ketë gjyrollogari të veten Muzeu.

Vatan Istrefaj- ka vërejtje rreth afatit të njoftimit për debat publik, njoftim i cili është bërë një ditë përpara debatit ndërsa dihet që njoftimi duhet të bëhet një javë para debatit ka thënë ai.

Miftar Ahmetxhekaj-thot se pajtohem që janë bërë ndryshimet në tekstin e statutit sipas rekomandimeve të kuvendit, neni 3 pika 1 duhet te jete me dt 31.03.2022 themelohet Muzeu Etnologjik i Deçanit, neni 5.3 Pasuria (artefaktet) janë pasuri e komunës së Deçanit, kurse ndërtesa (Kulla) është pronë e IKMM), ndërsa te neni 11 te rekrutimi i drejtorit te muzeut ndoshta është ma mirë që ti referohemi ligjit te punës.

Hyri Dobdrunaj- thot se rregullorja e punës dhe vendimi per orarin e mbajtjes se mbledhjeve duhet te respektohet sepse KPF sipas orarit duhet te mbahet dy dite para mbledhjes se asamblesë ndërsa ne kete rast eshte mbajte mbledhja e KPF te premten kurse sot e hëne mbledhja e Asamblese dhe kjo nuk konsiderohet afat sepse e shtunë dhe e dielë janë vikend, pastaj lidhur me Statutin e muzeut, ka thënë se duhet të bëhet një plan, se si duhet të funksionon mirë muzeu, Muzeu duhet ta kete gjyrollogarinë e vet rrjedhëse pasi qe ka drejtor te vetin dhe e përkrahi kete statut nëse futet neni që përcakton se Muzeu ka gjyrollarinë e vet rrjedhëse.

Albesa Cacaj- thot se mendoj që Muzeu duhet ta kete gjyrollogarinë e vet rrjedhëse dhe e përkrahi në këtë formë përndryshe nëse nuk përcaktohet kjo do të votoj kundër miratimit të këtij statuti për këtë arsye.

Drejtoresha – sqaron rreth funksionimit të muzeut në mes tjerash ajo sqaron muzeu duhet të ketë edhe buxhet të vetin.

Florim Mataj- thot se pajtohem me vërejtjet e opozitës, meqenëse drejtoresha po deklaronte se Muzeu duhet të ketë buxhet të vet, unë e shtroj pyetjen, kush do ta menaxhon ate buxhet dhe si, mirëpo kete here kërkoj qe miratimi i këtij statuti te behet nga te gjithë pa dallim, pozitë opozitë.

Miftar Ahmetxhekaj- thot se ne aspektin ligjorë nuk është njëjtë nëse do ta kete apo jo gjyrollogarinë e vet rrjedhëse sepse edhe Muzeu etnologjik i Pejës e ka gjyrollogarinë, në aspektin juridik është institucion që e ka kriju Kuvendi i Komunes prandaj edhe duhet te sqarohen këto gjana.

Orges Tafilaj- thot se si dokument material na ka ardhë si draft Statut prandaj kërkoj që të bëhen një herë ndryshimet e pastaj e votojmë, pastaj ka shtuar se nuk po më pëlqen gjuha që po përdoret për debat publik.

Mon Selmonaj- pyet, a kini mëndu se ndonjëherë do të ketë donacione dhe si do të rregullohet kjo gjë nëse Muzeu nuk ka gjyrollogari te veten, prandaj ndoshta është ma mirë të shtyhet deri sa të sqarohet çështja e llogarisë rrjedhëse, duhet ose nuk duhet ta ketë Muzeu gjyrollogarinë e vet rrjedhëse.

Arjan Dobraj- thot se si draft Statut ka ardhë në muajin Prill në leximin e parë tash ka ardhë si statut i cili duhet të miratohet si i tillë.

Faton Selmanaj- thot se pajtohem me Monin se duhet të rregullohet edhe çështja e gjyrollogarisë edhe sa i përket donacionit dhe ndoshta per kete arsye është ma mirë që të shtyhet sot si pikë.

Shkodran Mustafaj- pyet, se a ka të hyra Muzeu, dhe sa i përket gjyrollogarisë nëse do të ketë muzeu llogari te vet rrjedhëse kush e menaxhon ate pasi qe muzeu eshte ne kuadër te Komunes.

Hyri Dobrunaj- thot se gjyrollogarinë rrjedhëse Muzeu duhet ta kete pasi qe e ka drejtorin qe e menaxhon, ka donacione, ka te hyra prandaj duhet ta kete gjyrollogarinë e vet rrjedhëse, mirëpo për këtë çështje edhe një herë drejtoresha ti drejtohet MAPL-së me kërkesë, a duhet të ketë apo jo Muzeu gjyrollogari të vet rrjedhëse.

Kryesuesi- thot se nuk e shof si pengesë nga këndi im nëse muzeu ka gjyrollogari te vet rrjedhëse, prandaj pajtohem me propozimin qe ta kete ate.

Erdogan Dautaj- thot, nëse me ligj parashihet qe te kete gjyrollogari te vet rrjedhëse muzeu, atëherë pse mos ta kete ate.

Drejtoresha thot se edhe një herë do të kontakton me ministrinë dhe do ta sqaron, se lejohet apo nuk lejohet qe te përcaktohet në statut që muzeu ta kete gjyrollogarinë e vet rrjedhëse.

Kryesuesi- thot, me mundësinë që Muzeu ta kete gjyrollogarinë vet rrjedhëse e qes në votim Statutin e Muzeut në Deçan, antarët e kuvendit njëzëri e miratojnë ate.

IV. Raporti vlerësues i Programit tre vjeçarë për Banim social në komunë 2018-2020 dhe marrja e vendimit për hartimin e Programit Komunal për banim social 2022-2025.

Kryesuesi e ka prezentu kete pikë pastaj per sqarime e ka ftuar Ajne Ibërhyasaj, zyrtare Komunale e autorizuar nga Kryetari për të sqaruar lidhur me temën. Ajne Ibërhyasaj- ka sqaruar lidhur me

programin tre vjeçarë për Banim social në komunë 2018-2020, në kuadër të kësaj ajo sqaron rreth Objektivit për banim social dhe 14 shtëpi në lagjen Baballoq që menaxhohen nga komuna, ajo njofton se ka qenë e planifikuar që të ndërtohet një objekt për banim social në 2017 dhe një në 2018 por që nuk janë bërë dhe kanë qenë të planifikuara për strehim të 32 familjeve, mungojnë të dhënat në faqen zyrtare për familjet që banojnë në objektin social. Plani i monitorimit dhe zbatimit të objekteve bëhet nga ministria, realizimin duhet ta bëjnë drejtoritë komunale, plani 2012-2017 15% është realizu, komuna në këtë drejtim nuk ka pasë financim.

Erdogan Dautaj- thot se e përgëzoi Ajnen për hartimin e këtij raporti, pastaj e shtron pyetjen, sa është duke u zbatuar ky program, pastaj shton se mandatin e kaluar e kemi pasë formu një komision të kuvendit për verifikim të gjendjes në Objektin social dhe për shtëpitë në Lagjen Baballoq të cilat menaxhohen nga Komuna, tash prap propozoj që të formohet një komision i natyrës së njëjtë, ai komision duhet ta ketë për detyrë që të shiqon dhe vërteton se si po menaxhohen këto objekte, a po shfrytëzohen apo jo nga ata që jau kanë dhënë në shfrytëzim apo jo, sepse sipas të dhënave 50% i shfrytëzojnë ata që i kanë përfitu, kurse 50% të banesave ose nuk shfrytëzohen ose shfrytëzohen nga personat e tretë.

Orges Tafilaj- duke u ndërlidhur me fjalinë e parë të raportit pyet, për trollin për ndërtim të objektivit për banim social ku është dhe a ndiheni të kënaqur me realizimin e këtij programi social me 15%.

Ajne Ibërsysaj- përgjigjet se 15% i realizimit është nxjerrë nga ajo që ka qenë e planifikuar dhe nga të dhënat që kryetari i Komunës ka nda mjete për të ndihmuar këtë kategori dhe na ka dalë kjo përqindje.

Hyri Dobrunaj- ka shtruar pyetjen, raporti i cili ka ardhë në asamble si dhe sa është realizu, përgjegjësinë për dështimin e planit kush e merr, të dhënat për banorët (për 14 shtëpitë a jan në menaxhim të komunës apo jo në Lagjen Baballoq).

Ajna-sqaron se baza e të dhënave është planifikim për ndërtim të dy objekteve të cilat nuk janë ndërtu, në këtë drejtim kanë dështuar politikat sociale për ndërtim të objekteve me karakter social, dhe tash për periudhën e ardhshme tre vjeqare kërkohet hartim i programit të ri, të ardhshëm.

Miftar Ahmetxhekaj- kur i referoheni ligjit të propozim-vendimi të rishikohet kjo dispozite sepse neni 14 pika 11 e rregullon këtë fushe, neni 55 i statutit duhet të bëhet neni 56, të qartësohet si term banim dhe strehim social .

Arjan Dobraj- pyet për Lagjen Baballoq, a keni dalë në teren për ta vërtetuar gjendjen dhe nëse nuk keni dalë në teren propozoj që të dilni dhe ta vërtetoni gjendjen faktike si është, dhe cilat kritere aplikohen për vendosjen e një familje në një objekt për banim social, për të cilat është sqaruar nga Ajna.

Mon Selmonaj- thot se unë jam një nga anëtarët e komisionit të mandatit të kaluar, pastaj sqaron se si komision i kemi mbajtur 10 mbledhje dhe kemi dalë në teren për verifikim të gjendjes në objektin për banim social në Deçan dhe 15 shtëpitë në Lagjen Baballoq. Si komision kemi hartu raport dhe kemi konstatu se ka shkelje të rënda, raportin e kemi dorëzuar në ekzekutiv por nuk ka ardhë kurrë këtu për shqyrtim, kurse tash siq jemi në këtë situatë, propozoj që ma mirë është që të rishikohet edhe një herë gjendja momentale në teren .

Albesa Cacaj-para se të vini të plani për vitet e ardhshme propozoj që të rishikohet ish plani dhe të bëhet një raport detaj sa është realizu dhe ku ka ngecë çështja, pse nuk është realizu plani 2012-2017. Florim Mataj-thot se neve sot na ka ardhë një vendim për hartimin e planit 2022-2026, mirëpo nuk kemi raport të shkruar për Programin tre vjeçarë për Banim social në komunë 2018-2020, komisioni i kuvendit pjesë e të cilit ka qenë Moni është dashtë ta harton raportin e punës së tij pas daljes në teren dhe ta bjen në kuvend dhe ta shqyrtojme këtu bashkarisht e të shohim se ku jemi në këtë çështje.

Mon Selmonaj, antar i Komisionit të Kuvendit për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes në Lagjen Baballoq dhe në objektet e karakterit social në Komunën e Deçanit (themeluar me 31.10.2018), detalisht ka sqaruar për punën dhe angazhimet e komisionit, ai ka thënë se kemi dalë në teren dhe për së afërmi e kemi pa gjendjen se si qëndron, e kemi hartu raportin dhe e kemi prurë në Komunë për ta proceduar ma tutje në Kuvend për shqyrtim, mirëpo me gjithë insistimet tona si komision ai raport

asnjëherë nuk ka dalë në Kuvend për shqyrtim dhe asnjëherë nuk jemi kompenzuar me mëditje edhe pse na është premtu disa herë.

Faton Selmanaj- thot se këtë çështje e kam ngritë edhe në KPF dhe po e ngriti edhe këtu në Kuvend, se është mirë që ta kemi një plan dhe një analizë sa i përket banimit social në komunë, po flitet këtu se janë keqpërdorë ato shtëpi dhe ne dëshirojmë të dijmë cili është statusi i atyre shtëpive, a i kanë në shfrytëzim ata njerëz apo janë pronarë të atyre 14 shtëpive në Lagjen Baballoq.

Ajne Ibërhyasaj- sqaron se është mbështetë programi nga Zyra e kryetarit, ndërsa raporti i ish komisionit mund të shërben si bazë për hartimin e raportit për periudhën e ardhshme.

Kryesuesi- e pyet kuvendin nëse dëshirojnë prap të formojnë një kosion të ri për këtë çështje.

Albesa Cacaj- thot se jam dëshmitare që formojmë komisione dhe nuk jemi në krye të detyrës që na ngarkohet sepse asgjë nuk arrihet me këto komisione.

Florim Mataj- propozon që në seancën e radhës të kuvendit të na vjen një raport për periudhën tre vjeçare të programit të kaluar e pastaj vendosim për hartimin e Programit 2022-2026.

Agnesa Vokshi, drejtoreshë e drejtorisë për Shëndetësi sqaron se 11 shtëpi në Lagjen Baballoq janë të bartura në pronësi të Komunës.

Erdogan Dautaj- propozon që fillimisht të ngritët një komision i cili do të del në teren për ta vërtetuar gjendjen aktuale si është, ai komision ta harton një raport qysh është gjendja e pastaj e hartojmë programin e ri.

Miftar Ahmetxhekaj- thot se fillimisht duhet ta kemi një raport për të kaluarën e pastaj të merremi me hartimin e programit të ri.

Kryesuesi- e qiti në votim propozimin që ka ardhë në kuvend për hartimin e programit 2022-2026, antarët e kuvendit e miratojnë me 22 vota për dhe 4 apstenim.

V. Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.

Arjan Dobraj, kryetar i grupit parlamentar të AAK-së në emër të grupit, propozon për anëtar të Grupit punues:Leotrim Hadergjonaj, Bekim Vishaj dhe Shkelzen Shehu.

Miftar Ahmetxhekaj- thot se nuk e kam të qartë se cilat kanë me qenë ingjirencat e këtij grupi, prandaj kërkoj sqarim në këtë drejtim, në vazhdim ai ka thënë se unë sot propozoj që të bëjmë komision për promovimin e trashëgimisë kulturore në Komunë, pastaj propozon që të lirohen nga tatimi të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore, propozoj ka thënë ai, që të merret vendim që të lirohen nga pagesa nxjerrja e Fletëve poseduese për të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore, pastaj ka sqaruar se sipas ligjit , trashëgimia kulturore përfshin trashëgiminë arkitektuale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore.

Erdogan Dautaj- thot se pajtohem me atë çka tha parafolësi im, Miftari, dhe tash ne duhet ta formojmë grupin punues i cili duhet të merret me hartimin e planit, ndërsa sugjerimet e Miftarit janë shumë të mira dhe të qëlluara.

Orges Tafilaj- thot se po shqyrtohet kjo pikë dhe është jo në rregull që drejtoresha e drejtorisë përkatëse mos me qenë fare këtu në sallë për të dhënë sqarime, nëse kërkohej, pajtohem me diskutimin e Miftarit, dhe tuj marrë parasysh se nuk është bash e qartë situata dhe drejtoresha si person kompetent për të dhënë sqarime nuk është prezent, propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Mon Selmonaj-thot se më intereson se kush është sponzorizues i kësaj pike dhe interesimi im vjen nga fakti se kërkoj sqarime, ndërsa unë propozoj në këtë grup punues një eksperte të kësaj fushe, Ardiana Qorraj.

Florim Mataj-mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet për mbledhjen tjetër, me arsyetimin që të kompletohet si pikë materiali i mbledhjes dhe të jetë prezent drejtoresha për të dhënë sqarime.

Leotrim Hadergjonaj- thot se edhe unë e kam të njëjtin mendim, që mos të shqyrtohet pika në mungesë të drejtoreshës.

Kryesuesi- e qiti në votim propozimin për shtyerjen e kësaj pike për mbledhjen tjetër, me 25 vota për dhe i kundër, shtyhet për mbledhjen tjetër pika nr.5 Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.

VI. Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për barazi gjinore.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Hyri Dobrunaj- propozon që të shtyhet edhe kjo pikë e rendit të ditës meqenëse askush nga ekzekutivi nuk është këtu për të dhënë sqarime, kërkoj që të vjen në sallë prezentuesi i çështjen pastaj të shqyrtohet pika.

Ajne Ibërhysaj- fillimisht thot se edhe për këtë pikë është e autorizuar nga kryetari i Komunës për të dhënë sqarime, autorizimi i është bërë në cilësinë e ekspertes së fushës, ndërsa nga kuvendi kërkohet themelimi i grupit punues, ndërsa unë e ndihmoj si eksperte, meqenëse është e nevojshme që si komunë ta hartojmë këtë dokument të cilin nuk e kemi pasur kurrë, sepse në mungesë të tij jemi penalizuar dhe do të penalizohemi prap kur bëhet vlerësimi i performancës së komunës nga MAPL, unë jam për hartimin e tij dhe kërkoj nga ju sot, që mos të shtyhet si temë.

Yllarta Thaqi- thot se deri sa ne si komunë e kemi një zyrtare për barazi gjinore, mendoj se ajo duhet të jetë këtu prezent në mbledhje kur debatohet kjo temë.

Florim Mataj- thot se edhe unë jam për shqyrtimin e kësaj pike meqenëse u dhanë sqarimet rreth saj.

Miftar Ahmetxhekaj-thot se është dashtë që ta kemi edhe ne dokumnetin që ka ardhë nga Ministria, a është e argumentuar kjo që thuhet, a është e shkruar, nëse ka, ku janë ato shkresa.

Ajna-thot se këto shkresa janë te përfaqësimi gjinorë, te fusha e performancës komunale, aty kërkohet ky dokumnet, dhe nëse nuk e kemi penalizohemi me shumë pikë.

Hyri Dobrunaj-nuk është e vërtetë që nuk kemi pasë kurr Plan për barazi gjinore sepse në mandatin që kamë qenë unë asambliste, grupi i grave asamblistë në përkrahje edhe të OSBE-së e kemi hartu kete dokument, Zyrtarja per barazi gjinore po e potencoj per te saten here se duhet ta kete Zyren te Zyra e Kryetarit, unë e mbështes kete çështje por kërkoj që të reflektohet në këtë drejtim edhe nga organet komunale dhe të tjerët që mund të kontribuojnë.

Mon Selmonaj- per 22 vite mos me pasë Plan per barazi gjinore është pak e quditshme dhe e pa pranueshme.

Faton Selmanaj- prej 2013 i monitoroj seancat e kuvendit dhe nuk ka ardhë zyrtarja per barazi gjinore në mbledhje të Kuvendit, shpresoj në të radhmen që të merr pjesë në mbledhje.

Formohet grupi punues :Zoje Sejfiqaj, Ajne Iberhysaj, Yllarta Thaqi, Hyri Dobrunaj dhe Teuta Neziraj.Kjo përbërje e komisionit miratohet njëzëri.

Takimin e parë të grupit punues e thërret kryesuesi i Kuvendit, në atë takim Grupi punues e zgjedhë kryesuesin e vet, nga radhët e veta.

Pauzë

Pas pauze, në mungesë të kryesuesit, punimet e mbledhjes i ka udhëheqë Mon Selmonaj, anëtar i më i vjetër i Kuvendit.

VII. Themelimi i komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave.

Mon Selmonaj, në cilësinë e kryesuesit të mbledhjes e ka propozuar pikën, ka dhënë disa sqarime, pastaj e hapë debatin rreth kësaj teme.

Erdogan Dautaj- propozon që të shtyhet edhe kjo pikë e rendit të ditës meqenëse nuk është prezent drejtori i Administratës për të dhënë sqarime.

Florim Mataj- edhe pse nuk është drejtori prezent propozoj që kjo pikë të shqyrtohet.

Erdogani- të shtyhet.

Leotrim Hadergjonaj- thot se po flas si një prej kryetarëve të Këshillave të fshatrave, dhe është shumë e nevojshme që të kryhet kjo punë.

Miftar Ahmetxhekaj- thot se kjo temë e zgjedhjes së Këshillave lokale të fshatrave dhe kryetarëve të këtyre Këshilla, është kategori ligjore dhe është e nevojshme që të zgjedhën Kryetarët e Këshillave Lokale.

Faton Selmanaj-mendoj se është në rregull që kjo pikë të shtyhet meqenëse drejtori nuk është dhe për këtë duhet të pajtohen edhe pozita.

Yllarta Thaqi- thot se është e panevojshme që të shtyhet sepse kryetarët e këshillave janë pa mandat dhe zgjedhja e kryetarëve të rinjë kërkon kohë, sepse është një procedurë bukur e gjatë.

Hyri Dobrunaj- kjo çështje është kategori ligjore por jemi pajtu ma herët që mos mi shqyrto asnjë pikë atëherë kur nuk është prezent drejtori përkatës, është çështje me rëndësi në të mirën e qytetarëve por nuk eshte e arsyeshme mi shqyrto pa drejtorin prezent.

Orges Tafilaj- thot se ne jemi këtu për të miratu rregullore dhe vendime dhe ato vendime pastaj duhet të zbatohen prandaj unë jam kategorik që kjo pikë të shtyhet për shkak të mungesës së drejtorit në mbledhje.

Arjan Dobraj-thot, propozoj me shku me propozime konkrete për themelimin e grupit punues.

Mon Selmonaj- thot se disa çështje që i ngrita unë nuk i potencoj askush, a ka me marrë mëditje komisioni për punën e vet dhe a ka me pasë mbështetje logjistike nga komuna gjatë daljes në teren.

Adem Lushaj (OJQ) sqaron se si ka funksionu komisioni në 2018 kur është bërë zgjedhja e Këshillave Lokale dhe kryetarëve të Këshillave lokale .

Arjan Dobraj- kërkon që mos të qiten pengesa në këtë drejtim sepse është në të mirë të përgjithshme të qytetarëve kjo punë.

Faton Selmanaj- deri sa kemi marrë vendim që në mungesë të drejtorit mos të shqyrtohet asnjë pikë kërkoj që kjo pikë të shtyhet meqenëse drejtori përkatës nuk është në sallë, ose, a ban që të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme për një ditë tjetër dhe të shqyrtohet kjo pikë dhe pika tjetër që u hiq.

Florim Mataj- thot meqenëse është procedurë e gjatë dhe kërkon kohë deri sa të kryhet ky proces propozoj që të vazhdojmë me propozimin e emrave.

Arjan Dobraj- ne emer te grupit te AAK-së thot se jemi pro dhe propozoj qe sot te vazhdohet me procedure te formimit te komisionit.

Hyri Dobrunaj- edhe ne si LDK, jemi pro, por jo sot, propozoj qe te shtyhet.

Faton Selmanaj- edhe ne si VV jemi pro formimit te komisionit dhe zgjedhjes se Keshillave lokale por jo sot, mund ta thirrni nje mbledhje te jashtezakonshme per nje dite tjeter.

Florim Mataj- kerkon nga kryesuesi i mbledhjes, Mon Selmonaj qe ta hedh ne votim qe te vendoset ose te shtyhet si pike ose te vazhdojme me procedure te formimit te komisionit.

Ne nderkohe vjen kryesuesi i kuvendit, Hajdar Sutaj dhe vazhdon me kryesimin e mbledhjes.

Mon Selmonaj-lidhur me kete çështje thot se janë disa dilema që duhet të sqarohen këtu, siç është problemi financiarë(mëditjet e komisionit) sigurimi i transportit të anëtarëve të komisionit, ne kete rast thot ai mungesa e drejtorit në sallë ka shkaktuar kokqarje dhe nuk jam per ate qe me funksionu ky komision pa mbështetje logjistike dhe pa mëditje.

Arjan Dobraj, shef i grupit te AAK-së ka propozuar per antar te komisionit, Jashar Dobraj nga Ekzekutivi, Fekri Qufaj dhe Afrim Demhasaj nga Asambleja (AAK) dhe Sanije Thaqi nga sektori jo qeveritar.

Hyri Dobrunaj- ka reaguuar kur është propozuar nga kryetari i grupit të AAK-së, i cili është jo kompetent për këtë çështje, dhe propozon për anëtare të komisionit nga sektori jo qeveritar Sanije Thaqi, dhe në shenjë mospajtimi me këtë, opozita (LDK dhe LVV) e kanë lëshuar sallën.

Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e kryetarit të grupit të AAK-së, (dy anëtarët nga asambleja Fekri Qufaj dhe Afrim Demhasaj dhe 1 nga ekzekutivi, Jashar Dobraj) i cili miratohet njëzëri, komisioni plotësohet mbledhjen e radhës me anëtarët nga radhët e opozitës dhe OJQ.

VIII. Raporti vlerësues për ish PLVM 2012-2017 dhe marrja e Vendimit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2022-2026

Prezent në sallë 18 anëtar të Kuvendit(14 - AAK, 3 - LVV dhe 1- PDK).

Kryesuesi e ka prezentu kete pike pastaj per sqarime fjalën ia ka dhene zyrtares komunale Ajne Ibërhyasaj, e autorizuar nga kryetari per te dhene sqarime, ne vazhdim ajo ka sqaruar se plani ka qenë gjithperfshires dhe janë identifikuar 40 probleme, realizimi planit është 80%, proritët mbeten ujrat e zeza dhe shumë projekte të tjera.

Florim Mataj-pyet, nëse ka mundësi te sqarohet se cilat çështje janë prioritet që pritet të planifikohen dhe realizohen me hartimin e planit lokal të Veprimit në Mjedis 2022-2026.

Ajne Ibërhyasaj- përgjigjet se për momentin paraprakisht nuk mund të thot se cilat janë ato prioritetë, por grupi punues por do të bënë identifikimin e problemeve dhe ato do të jenë pjesë e planit që do të hartohet.

Mon Selmonaj- pyet, pse ky vlerësim i këtij plani nuk është bërë në legjislaturën e kaluar meqëse plani për të cilin po raportohet është i periudhës 2012-2017, Si dhe krahasuar me gjendjen në teren as 10% e këtij plani nuk janë realizuar nga këto që potencove ti, poashtu kush duhet të bënë raport për periudhën 2017-2022 periudhë që planit i ka kaluar afati.

Ajne Ibërhysaj- thot se plani është aprovuar në 2012 deri 2017 kurse pre 2017 deri 2022 i takon drejtorisë së Urbanizmit të ep raport.

Orges Tafilaj- thot se Planit është per periudhën 2012-2017 dhe kisha dashtë sqarime ma shum sepse kjo nuk është as e përafërt me ate që kërkohet, ndërsa pyetje konkrete lidhur me planin: çështja Infrastrukturës të Ujit të Thart, problemet e kanalizimit të ujrave të zeza, Kolektori Lumbardh, Kolektori Dranoc, Bashkëpunimi i Komunës me IPA-n dhe propozimin e buxhetit për hartimin e planit të ri kush e ka përgaditë.

Ajna – propozimin e buxhetit unë e kam përgaditë.

Orges Tafilaj- në pjesën e fundit të propozimit të buxhetit është pozicioni – përkthimi i planit në gjuhën serbe, 500 libra, shtrohet pyetja pse mendoni se duhet të botohen 500 libra, propozimi i punëtorisë jasht Kosove-cila është ideja, ekspertët 500 euro, në fund ai ka thënë se kishte qenë mirë që të bëni një plan për të ardhmen dhe kërkoj nga ju si inicuese që të rishikoni edhe një herë këtë kalkulim.

Ajne Ibërhysaj- përgjigjet se është konsultuar me drejtorin e Urbanizmit për projektet, ndërsa kur të hartohet një plan duhet të angazhohen ekspertët nga jashtë.

Orges Tafilaj- të lutem për projekte konsultou me drejtorin.

Meqenëse nuk kishte diskutime tjera Kryesuesi e qiti ne votim propozimin per marrjen e Vendimit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2022-2026, ndërsa propozimi për ndarjen e buxhetit duhet të rishqyrtohet edhe një herë

Anëtarët e Kuvendit e miratojnë me shumic votash, 14 per (AAK), 4 abstenim(3 VV dhe 1 PDK).Kuvendi merr vendim për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2022-2026, pa pjesën e propozuar me kalkulime financiare.

IX.Shqyrtimi i kërkesës së Lagjes Nuraj nga fshati Strelle i Ulët për ndarjen e parcelës për varreza të Lagjes Nuraj, kërkohen 20 ari nga parcela e evidentuar si pronë komunale.

Orges Tafilaj- thot se nga informtatat per gjendjen ne teren e kemi kuptuar se kjo Lagje nuk kanë hapsirë të mjaftueshme për varreza prandaj si VV, kërkesën për ndarjen e 20 ari për varreza të lagjes Nuraj ne e përkrahim.

Miratohet njëzëri me 18 vota (18 prezent). Me këtë vendim caktohet lokacioni me destinim për varrezat e Lagjes Nuraj të fshatit Strelle i Ulët, në pjesën e parcelës nr.01108-0, me sipërfaqe të përgjithshme 4716 m², Njësia Kadastrale P-70511028-01108-0, Zona Kadastrale Strelle i Ulët, sipërfaqja me destinim për varreza të Lagjes Nuraj e caktuar me këtë vendim është S-2000 m², pronar Komuna e Deçanit. Pas vlerësimit të ligjshmërisë obligohet drejtoria për Gjeodezi të bënë ndarjen e parcelës.

X.Shqyrtimi i dorëheqjes së Enver Cacaj- nga Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë parcela nr.429-0 Zk Deçan.

Kryesuesi- e prezentoj dorëheqjen e Enver Cacaj nga pozita e anëtarit të Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë parcela nr.429-0 Zk Deçan. Në vend të Enver Cacaj propozon Leonora Ukëhajdaraj, në vazhdim e qiti në votim, miratohet dorëheqja e Enver Cacaj nga pozita e anëtarit të Komisionit vlerësues nga radhët e ekzekutivit dhe zëvendësohet në këtë komision nga radhët e ekzekutivit me Leonora Ukëhajdaraj. Vendimi merret me 14 vota për, asnjë kundër asnjë apstenim.

XI.Të ndryshme.

Orges Tafilaj- ka ngritë çështjen e bisedimeve nga Kryetari i Komunës me menaxhmentin e KRU “Hidrodrini” duke kërkuar sqarim si ka shku ai takim, dhe a është i përdorshëm për pije apo nuk është i përdorshëm për pije ai ujë.

-Qëndrimi juaj juaj për pronat që i ka marrë Manastiri dhe a do të vazhdon të kundërshtohet kjo çështje apo do të ja bartë pronat manastirit komuna.

Kryesuesi- thot se unë nuk kam pasë njoftim për takimin por sipas njoftimit dhe të dhënave të më vonshme, Kryetari i Komunës është takuar me përfaqësuesit e Hidrodrinit.

Mon Selmonaj, kryetar i grupit punues për bisedime me menaxhmentin e KRU “Hidrodrini” thot se kur unë jam propozuar kryetar i grupit punues ka qenë pak provokative sepse kur kryetari angazhohet vet personalisht dhe takohet me përfaqësuesit e Hidridrinit atëherë nuk ka nevojë për

formimin e asnjë grupi punues, sepse kryetari e kryen ate pune dhe ky grup që unë e përfaqësoj edhe pse i formuar nuk ka nevojë të ekziston deri sa kryetari i komunës angazhohet në këtë çështje dhe takohet me përfaqësuesit e hidrodrinit, sepse unë i besoj kryetarit të Komunës për të bisedu në këtë drejtim.

Kryesuesi- thot se problemi i ujit të pijes nuk është zgjedhë ende, ata i kanë thënë kryetarit se uji është i pijshëm por këtë e kanë thënë gojarisht dhe nuk kanë lëshuar asgjë me shkrim, andaj kërkoj që ju si komision të angazhoheni edhe një herë për bisedime me menaxhmentin e KRU "Hidrodrini" për kualitetin e ujit dhe sasinë e ujit të pijes, deri me dt.15 qershor me qenë i gatshëm si njoftim për mbledhjen e asamblesë që do të mbahet në qershor.

Florim Mataj-thot se ata (Hidrodrini) nuk na presin në takim si komision, prandaj propozoj që të merret kryetari me kete çështje dhe të na njofton për situatën e ujit të pijes.

Kryesuesi- ju inkurajoj që edhe një herë ju si komision të angazhoheni për këtë çështje.

Florim Mataj- ne angazhohemi por ata nuk na presin në takim.

Faton Selmanaj-sipas informacioneve, sivjet helmimi nuk ka ndodhë prej ujit siç është pretenduar por prej një virusi, ndërsa sa i përket takimit me Bordin , Kompania nuk ka Bord, sa i përket takimit me Gazmendin, ai duhet me na pritë sepse ne jemi të zgjedhurit e popullit.

Kryesuesi- unë vet personalisht do të kërkoj një takim me menaxherin në Pejë që të shofim si është puna, takimin do ta kërkoj unë, bashkë me ju, si grup natyrisht.

Faton Selmanaj-thot se ishte dashtë që drejtoresha e Shëndetësisë me qenë këtu prezent në sallë kur debatohet për këtë temë dhe me njoftu si qëndron puna.

Kryesuesi-qëndrimi im personal sa ju përket pronave që lidhen me Manastirin jam kundër.

Yllarta Thaqi- thot se kam bërë një pyetje për drejtorin e administrates por meqenë nuk është këtu drejtori kërkesa ime mbetet për mbledhjen tjetër, ndërsa për drejtorin e bujqësisë pyetje, cilat fshatra do të gëzohen me kanale të ujitjes sepse e kam pa postimin tuaj rreth bisedimeve që kisin zhvilluar në Ministri.

Mon Selmanaj-thot se edhe unë e kam pa takimin e drejtorit në Ministrinë e Bujqësisë dhe qe 20 vjet ne fshati Rastavicë jemi pa ujë, pyetje, a jemi na dhe Prejlepi në listë për sigurimin e ujit për ujitjen e tokave, si dhe rregullimi i Pendës së Lumit të Lloqanit.

Drejtori, Rifat Stojkaj i përgjigjet Yllartës, ai sqaron se me dt.19 kemi qenë në Ministri të Bujqësisë për herë të tretë, atje e kam qu një listë me shum kanale të ujitjes ku hyn edhe kanali-Llukë të Epërme, vitin e kaluar dy kanale i kemi hapë kah tereni juaj edhe në Prejlep kemi hapë kanale të ujites, përgjigje për pyetjen e Monit -Kanalin Prejlep_Rastavicë e kam dërgu në Minstri si projekt por thënë të drejtën nuk pres shumë për përkrahje të këtij projekti.

Florim Mataj- pyet drejtorin Rifat, cilat kanale i ki dërgu në ministri dhe sa është gjatsia e kanaleve.

Orges Tafilaj-pyet e përfshihet në atë listë edhe Vija e Gështenjës.

Rifat Stojkaj- përgjigjet për angazhimet rreth hapjes dhe pastrimit të kanalit -Vija e Gështenjës, mirëpo kjo është pak e komplikuar sepse nuk ka menaxher KRU Drini i bardhë në Deçan fare, mirëpo ne i kemi 33 projekte të kanaleve të ujitjes .

Fekri Qufaj-pyet, a jan përfshi presat në Carrabreg dhe Prejlep.

Rifati- sqaron se për dy vite Komuna ka ba marreveshje me Drinin e Bardhë për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes, as një kompetencë për ruajtje të tokave dhe menaxhim të ujit nuk e kemi. Drejtori i Drejtorisë për BPZHR, Rifat Stojkaj, hollësisht ka sqaruar për angazhimet e drejtorisë, angazhime të cilat janë përshëndetë nga asamblistët prezent.

Faton Selmanaj- pyet rreth procedurave për aplikim për subvencione për një pronë të cilën e merr personi nga një pronar tjetër dhe aplikon personi që do ta punon jo pronari i tokës.

Rifati sqaron se fermeri e bjen kërkesën të noterizume, zyrtari i komunës e digjitalizon parcelën dhe komisioni i Ministrisë pastaj e vëret në teren.

Lulavere Qorraj- e përgëzon drejtorin për punët e kryera pastaj shton se unë sot e prezentoj shqetësimin e punëtorëve shëndetësorë të cilët janë kafshuar nga qenët endacak, ajo kërkon që organet kompetente ta trajtojnë këtë problem me përkushtim sepse qenën endacak po paraqesin problem shumë të madh për sigurinë e qytetarëve.

Afrim Demhasaj-thot se çështja e qenëve endacak është problem nacional i cili kërkon zgjidhje.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lolluni



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

